



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Raport i Kreut të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri
në Këshillin e Përherëshëm të OSBE-së
2 qershor 2005

Hyrje

Gjatë tetë muajve të kaluar, që prej raportit të fundit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri në Këshillin e Përherëshëm, skena politike dhe institucionet shqiptare janë përqendruar në përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme për Kuvendin, caktuar për t'u zhvilluar më 3 korrik 2005. Rëndësia e këtyre zgjedhjeve për përmbushjen e angazhimeve të OSBE-së dhe standardeve ndërkombëtare, si për demokracinë shqiptare ashtu edhe për aspiratat për integrimin e vendit, është theksuar gjerësisht nga partnerët ndërkombëtarë të Shqipërisë dhe është njohur nga përfaqësimi politik shqiptar.

Duke pasur parasysh rëndësinë e zgjedhjeve të korrikut 2005, Prezenca është përfshirë plotësisht në mbështetjen e proceseve politike dhe teknike të reformës zgjedhore dhe përgatitjeve për zgjedhjet. Prezenca ka lehtësuar zgjidhjen e një sërë çështjesh të nxehta politike, si përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ndarja e zonave zgjedhore, ndërkohë që ka siguruar edhe ekspertizë teknike për të ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së listave të zgjedhësve, çështja kryesore problematike e dalë nga zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2003.

Në një kohë kur pritet që fushata zgjedhore të fillojë zyrtarisht, mund të vihet re një ndryshim i qartë në stilin e bërjes së fushatës. Ndryshe nga zgjedhje të mëparshme për Kuvendin, partitë dhe kandidatët po përvijojnë platforma dhe propozime për politika që përpiqen t'u japin përgjigje shqetësimeve të publikut në lidhje me cilësinë e jetesës. Megjithëse ende mund të dëgjohen retorika akuzuese të stilit të vjetër, një pjesë e mirë e tyre është zëvendësuar nga debate në lidhje me politikën tatimore apo shumën e caktuar për arsimin dhe shëndetësinë nga buxheti i shtetit. Ky përparim pasqyron zërin në zhvillim të shoqërisë civile dhe të grupeve të interesuara të publikut, vënë në dukje në raporte të mëparshme. Gjithashtu, kjo tregon një përparim të politikës shqiptare, shenjë e largimit nga sistemi tejet i polarizuar, që e ka karakterizuar vendin për një kohë të gjatë, drejt një sistemi që ofron mundësi zgjedhjeje më të qenësishme.

Evoluimi i Kuvendit të Shqipërisë gjatë katër viteve të fundit, duke u shndërruar në forum kryesor për shkëmbime politike dhe debate, është një tregues tjetër i këtyre ndryshimeve. Projekti i Prezencës për të mbështetur modernizimin e Kuvendit ka ndihmuar në një pjesë të këtij ndryshimi. Më konkretisht, miratimi i Rregullores së re të Kuvendit në fund të vitit 2004 thekson këtë zhvillim, duke e bërë Kuvendin më transparent e më të përgjegjshëm.

Nxitja e transparencës në procesin e politikëbërjes dhe përgjegjshmëria e vendimmarrësve është bërë pjesë e shumë prej nismave dhe projekteve të tjera të Prezencës. Në fushën e reformës ligjore dhe gjyqësore, Prezenca po mbështet një

pjesëmarrje më të madhe në procesin legjislativ dhe transparencë më të madhe në sistemin e gjykatave. Në zhvillimin e shoqërisë civile, Prezenca po mbështet aktivizmin qytetar në proceset politikëbërëse lokale nëpërmjet rrjetit të Qendrave të Zhvillimit të Shoqërisë Civile. Asistenca teknike e dhënë nga Prezenca në lidhje me legjislacionin për median është gjithashtu kyçe për promovimin e medias së lirë, të pavarur dhe të përgjegjshme.

Në lidhje me regjistrimin e pasurisë, Prezenca është gjithashtu duke vepruar me qëllim nxitjen e një transparence më të madhe për të luftuar korrupsionin duke qartësuar të drejtat e pronësisë. Ky është një hap thelbësor që nevojitet për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe planifikimin afatgjatë të administrimit të tokës. Gjithashtu, ai është parakusht për zgjidhjen e pretendimeve për rikthim dhe kompensim, një çështje në të cilën luan rol edhe Prezenca, si dhe për përfundimin e procesit të privatizimit.

Në fushat e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe asistencës për policinë, Prezenca ka punuar për të ndihmuar autoritetet shqiptare për zbatimin e Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe të Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Kjo po arrihet nëpërmjet forcimit të policisë kufitare me anë të trajnimeve në lidhje me trajtimin e migrantëve, azilkërkuesve dhe viktimave të trafikimit, si dhe nëpërmjet dhënies së pajisjeve të nevojshme për rritjen e kapacitetit të tyre operacional.

Veprimtaritë e mandatuara të Prezencës në fushat e reformës ligjore dhe gjyqësore, reformës zgjedhore, reformës administrative-territoriale, forcimit të kapaciteteve parlamentare, anti-trafikimit dhe anti-korrupsionit, zhvillimit të medias, mirëqeverisjes dhe zhvillimit të shoqërisë civile, si dhe asistencës për policinë ravijëzohen më në hollësi në këtë raport. Ato kryhen në bashkëpunim të plotë me autoritetet shqiptare, për t'i bërë ato të qëndrueshme dhe pronë të qeverisë, si dhe në bashkërendim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë të Prezencës. Prezenca është një prej katër anëtarëve të Sekretariatit Teknik të Donatorëve, së bashku me Komisionin Evropian, Bankën Botërore dhe PNUD-in, që mbështet strukturën kryesore të bashkërendimit të donatorëve. Me mbështetjen e këtij organi bashkërendues, qeveria ka miratuar së fundi të shumëpriturin Sistem të Planifikimit të Integruar, një mekanizëm i politikëbërjes, hartuar për ta bërë planifikimin e qeverisë më të efektshëm dhe më të harmonizuar, si dhe për të përmirësuar ndërveprimin e donatorëve me qeverinë.

Në përgjithësi, mandati i Prezencës i vitit 2003 vijoi të sigurojë një bazë të shëndoshë për punën e saj. Konsultimi dhe transparenca me vendin pritës, Shqipërinë, ka përparuar më tej, pasi të gjitha projektet kryesore të Prezencës janë konsultuar në mënyrë proaktive me qeverinë shqiptare përpara se të zbatohen.

Që prej shtatorit të kaluar, Prezenca ka vepruar me një numër punonjësish paksa më të vogël se numri i planifikuar prej 120 vetësh, kryesisht për arsye të vendeve bosh që nuk mund të plotësoheshin pjesërisht për shkak të mungesës së kandidatëve të kualifikuar dhe pjesërisht për shkak të buxhetit provizor. Buxheti i miratuar i Prezencës për vitin 2005 përfaqëson një ulje neto prej 3,2 % krahasuar me buxhetin e miratuar të vitit 2004. Pavarësisht nga kjo, vëllimi financiar i veprimtarive të financuara nga buxheti bazë i Prezencës është rritur pesë herë në krahasim me vitin 2004 (përafërsisht 260 000 Euro), falë edhe kursimeve të bëra në zëra të tjerë të buxhetit. Vëllimi i veprimtarive të

projekteve të financuara nga burime jashtëbuxhetore është rritur më tej në vitin 2005. Nga shuma e përgjithshme 3,8 milionë euro për të gjitha projektet e planifikuara jashtëbuxhetore, deri tani janë marrë 2,2 milionë euro, një pjesë e të cilave përfshin financim shumëvjeçar.

Reforma ligjore dhe gjyqësore (përfshirë edhe reformën për pronat)

Reforma ligjore dhe gjyqësore. Sistemi gjyqësor konsiderohet i prekur nga një nivel i lartë i perceptuar korrupsioni, që sjell besim të ulët të publikut te sistemi gjyqësor dhe institucionet që kanë lidhje me të. Duke qenë se një prej mjeteve parësore të luftimit të korrupsionit është transparenca dhe aksesimi në informacion, Prezenca ka ndjekur një përfaqje shumëplanëshe për nxitjen e transparencës brenda sistemit gjyqësor dhe procesit ligjbërës.

Në tetor 2003, Prezenca nisi Projektin për Zhvillimin e Gjykimit të Drejtë, i ngjashëm me nisma të ndërmarra nga misionet tjera të OSBE-së në rajon. Ndërkohë që disa aktorë ndërkombëtarë në Shqipëri janë të përfshirë në ndërtimin e kapaciteteve brenda sistemit të drejtësisë nëpërmjet trajnimit dhe mbështetjes logjistike, Prezenca është i vetmi aktor që vlerëson sistemin gjyqësor duke vëzhguar nga afër seancat gjyqësore dhe që jep vlerësime të drejtpërdrejta mbi përmirësimin e tyre.

Në shkurt 2005, Prezenca publikoi *Raportin e Ndërmjetëm të Projektit për Zhvillimin e Gjykimeve të Drejta*, duke u përqendruar kryesisht në mjediset ku zhvillohet gjyqi dhe problemet logjistike që pengonin sistemin gjyqësor gjatë fazës fillestare të periudhës së vëzhgimit tetor 2003 – korrik 2004. Raporti u pranua gjerësisht nga gjyqësori dhe më pas, në muajin shkurt, Këshilli i Lartë i Drejtësisë u kërkoi gjykatave të marrin në konsideratë rekomandimet e tij. Në përgjithësi, zyrtarë të gjykatave kanë rënë dakord me konstatimet e bëra dhe shohin interes në zbatimin e rekomandimeve. Duke pasur parasysh ndikimin konkret të *Raportit të Ndërmjetëm*, Prezenca po vazhdon me Projektin e saj për Zhvillimin e Gjykimeve të Drejta duke e zgjeruar atë për të përfshirë në raportin e saj përfundimtar edhe fusha e çështje që nuk janë diskutuar më parë.

Në dhjetor 2004, Prezencës iu kërkua nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore (KKGj) dhe nga Gjykata e Lartë të punonin bashkë për përmirësimin e etikës gjyqësore. Megjithatë gjyqtarët në Shqipëri shpesh e njohin mirë ligjin material dhe procedural që rregullon çështjet që shqyrtojnë, ende nuk janë trajtuar në mënyrë të mjaftueshme çështje të etikës gjyqësore që do t'i ndihmonin gjyqtarët të fitonin njohuri të thella në këtë fushë – një pamjaftueshmëri e pranuar para Prezencës edhe nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe Komisioni i Etikës i Konferencës Kombëtare Gjyqësore. Gjithashtu, Kodi aktual shqiptar i Etikës Gjyqësore nuk parashikon ndonjë mekanizëm që kërkon zbatueshmëri të detyrueshme të tij, duke lënë të paqarta pasojat në rast të shkeljes së tij. Prezenca dhe Komisioni i Etikës i KKGj-së kanë punuar bashkë që prej asaj kohe për të zhvilluar një plan veprimi me qëllim përmirësimin e etikës gjyqësore.

Reforma gjyqësore në Shqipëri duhet që herët a vonë të përfshijë edhe një publikim më të gjerë të vendimeve të gjykatës. Aktualisht, kërkohet të publikohen vetëm vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Prezenca ka konstatuar dëshirë të gjerë nga autoritetet shqiptare dhe gjykatat për të përmirësuar këtë gjendje. Gjithashtu, është hartuar një plan për shtimin e numrit të publikimeve nga Prezenca në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Megjithatë, për këtë projekt dhe për përpjekje të tjera për reformën gjyqësore, nevojitet financim i mëtijshëm në formën e projekteve jashtëbuxhetore.

Në lidhje me vetë procesin e hartimit të ligjeve, Prezenca ka punuar për të promovuar hapje dhe transparencë më të madhe. Pjesa më e madhe e legjislacionit tani hartohet nga

ministritë, në veçanti nga Ministria e Drejtësisë, para se të miratohet në Këshillin e Ministrave dhe të dërgohet për miratim në Kuvend. Gjatë vitit të kaluar ka pasur përmirësime në proceset konsultative para miratimit të legjislacionit, sidomos që prej ngritjes së Komisionit të Reformës Ligjore, por ende ndodh shpesh që legjislacioni të hartohet shumë shpejt dhe pa përfshirë palët e interesuara apo ekspertët e duhur.

Për përmirësimin e kësaj gjendjeje, Prezenca po bashkëpunon me Ministrinë e Drejtësisë me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së publikut në procesin e hartimit. Në janar 2005, një grup i personelit të ministrisë mori pjesë në të parën prej disa vizitave studimore të organizuara nga Prezenca për të eksploruar proceset legjislative në vendet anëtare të BE-së. Me kërkesë të ministrisë, do të ketë gjithashtu nisma të përbashkëta për të filluar ndërgjegjësimin e përgjithshëm të publikut për legjislacionin e ri me anë të njoftimeve në gazeta dhe programeve televizive. Po ashtu, Prezenca do të punojë me disa OJF me qëllim rritjen e kapaciteve të tyre për të dhënë komente mbi projektligje të ndryshme gjatë përgatitjes së tyre.

Reforma për pronën. Prezenca ndihmoi në hartimin e Ligjit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, miratuar në korrik 2004 pas një pune njëvjeçare, për të përmbushur detyrimin e afatit kushtetues që kishte skaduar që në vitin 2001. Kështu, Prezenca ka siguruar mbështetje për zbatimin e këtij ligji të ri duke i ofruar Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave asistencë teknike dhe financiare që prej tetorit 2004. Zbatimi i plotë i ligjit është penguar nga fakti se shumë afate kohore të parashikuara në ligj janë shkelur, ndërkohë që institucionet përkatëse shqiptare nuk kanë marrë hapat e nevojshëm për të përmbushur detyrimet e tyre. Megjithatë, pjesët kryesore të akteve nënligjore janë hartuar tashmë me asistencën e Prezencës dhe shumë prej komisioneve lokale të kthimit dhe kompensimit të pronave (që duhet të zbatojnë procesin) janë tani në funksionim. Një prej veprimtarive kyçe të projektit në vazhdim e sipër është monitorimi i zbatimit të ligjit të kthimit të pronave me qëllim sigurimin e një procesi të drejtë dhe transparent. Kuvendi, së fundi, votoi për shtyrjen për një vit të afateve për paraqitjen e kërkesave, deri në vitin 2006, që do të thotë se shlyerja për pretenduesit e mundshëm nuk do të fillojë para vitit 2007.

Megjithatë, ende mbeten shqetësime përmasat e mundshme të detyrimeve shtetërore sipas skemës së kompensimit. Si një prej akteve të tij të fundit, Kuvendi miratoi Metodikën e Propozuar të Vlerësimit të Tokës në prill 2005, përgatitur nga Komisioni Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Metodika përcakton vlerën e tokës bujqësore, urbane dhe turistike, si dhe të ndërtesave në këto toka, e nevojshme për të nisur kompensimin fizik të pronës për ish-pronarët. Para miratimit të kësaj metodike, Prezenca, në bashkëpunim me FMN-në, Bankën Botërore dhe Komisionin Evropian, i shprehën Kuvendit shqetësimin e tyre për faktin se nuk ishte ndërmarrë një rishikim i pavarur i metodikës së propozuar dhe se, në formën e saj aktuale, metodika mund të sjellë pasoja të konsiderueshme në buxhet (ndoshta në miliarda euro) duke ndikuar drejtpërsëdrejti në aftësinë e qeverisë për të zbatuar përparësitë e zhvillimit social-ekonomik të vendit për vitet në vijim.

Në fund të vitit 2004, gjatë hartimit të akteve nënligjore përkatëse, u bë e dukshme se një zgjidhje e drejtë dhe e plotë e kthimit dhe kompensimit varet nga të dhëna të qarta të të drejtave të pronësisë dhe, për rrjedhojë, Prezenca arriti në përfundimin se ligji i kthimit të pronave nuk mund të zbatohet si duhet në ato zona ku regjistrimi i pasurisë

nuk ka përfunduar. Të dhënat me informacionin e nevojshëm për të gjykuar në lidhje me pretendimet janë siguruar vetëm nëpërmjet një procesi të njohur si “Regjistrimi i Parë”, që ka të bëjë me rievimin sistematik, përgatitjen e hartave dhe regjistrimin e titullit ligjor të pasurisë së paluajtshme. Zonat kryesore urbane dhe zonat bregdetare mbeten të paregjistruara - pikërisht zonat ku tregu i tokës është më aktiv dhe ku potenciali i zhvillimit ekonomik është më i madh. Për rrjedhojë, regjistrimi i pasurisë së paluajtshme në këto zona është një çështje urgjente. Prezenca dhe Sistemi shtetëror i Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme kanë identifikuar 60 zona kadastrale si zona me përparësi.¹

Në mars 2005, Norvegjia u angazhua të japë fondet dhe USAID-i dha Prezencës harta të përditësuara satelitore për të vazhduar me Regjistrimin e Parë në zonat e identifikuara urbane dhe bregdetare me përparësi. Veprimtaritë e Regjistrimit të Parë janë caktuar për të filluar nën drejtimin e Prezencës në qershor 2005 dhe të vazhdojnë deri në vitin 2007, kohë në të cilën procesi pritet të merret plotësisht në dorë nga qeveria. Sistemi shtetëror për Regjistrimin e Pasurisë së Paluajtshme nuk është aktualisht në gjendje të marrë autorësi të plotë të Regjistrimit të Parë dhe ta zbatojë atë me hapin dhe qëllimin e kërkuar për shkak të kufizimeve në buxhet dhe burime njerëzore. Prandaj, puna e Prezencës përfshin gjithashtu ndjekjen në nivel politikash të një strategjie afatgjatë të qendrueshmërisë. Prezenca është duke punuar gjithashtu me partnerët e saj ndërkombëtarë, në veçanti me Bankën Botërore dhe Komisionin Evropian, për të siguruar mbështetje nga donatorët për një nismë të plotë që do të trajtojë reformën e përgjithshme të tokës dhe strategjinë e administrimit të tokës për Shqipërinë, duke përfshirë përfundimin e Regjistrimit të Parë. Deri atëherë, Prezenca po e plotëson këtë boshllëk duke ndihmuar në Regjistrimin e Parë me qëllim që ritmi, metodika dhe baza e njohurisë të mos humbasin.

Çështja e së drejtës mbi pronën dhe siguria e tapisë kanë një ndikim të dallueshëm mbi aspektet sociale, ekonomike dhe politike të vendit. Për shembull, mungesa e të drejtave të sigurta mbi pronën pengon zhvillimin ekonomik të vendit, është burim kryesor i çështjeve civile në gjykata, si dhe ndikon në rritjen e korrupsionit. Informacioni i regjistrimit të pasurisë është e dhëna bazë që nevojitet për të mbështetur një larmi nismash të tilla si zgjidhja e çështjes së kthimit dhe kompensimit të pronave, procesi i vazhdueshëm i decentralizimit të qeverisë, planifikimi urban dhe rajonal, përmirësime në infrastrukturën e vendit, zhvillimi i turizmit dhe administrimi i burimeve natyrore. Më tej, vazhdimi i Regjistrimit të Parë mbështet veprimtari të tjera të Prezencës duke përfshirë Projektin për Mbështetjen e Organeve të Qeverisjes Vendore dhe procesin e reformës administrative-territoriale.

Reforma administrative territoriale

Në shtator 2004, marrëveshja e lehtësuar nga Prezenca midis qeverisë dhe opozitës i hapi rrugë ngritjes së një komisioni parlamentar të posaçëm për mbikqyrjen e çështjes së reformës administrative territoriale, duke filluar me rishikimin e projektligjit të propozuar nga qeveria, që rregullon procesin e bashkimit të njërive të qeverisjes vendore. Duke pasur parasysh rëndësinë mbizotëruese të reformës zgjedhore që po zhvillohet ndërkohë dhe, rrjedhimisht, rolin e rëndësishëm të luajtur nga Ministria e

¹ Sipas informacionit të dhënë nga Sistemi i Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në Shqipëri ka 3058 zona kadastrale gjithsej, prej të cilave janë regjistruar 2402. Në zonat rurale, janë regjistruar 2377(82%) prej 2920 zonave; kurse nga 138 zonat urbane janë regjistruar vetëm 25 (18%).

Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit në përgatitjen e zgjedhjeve, komisioni nuk ka bërë asnjë përparim thelbësor.

Kuptohet se kjo çështje do të ritrajtohet pas zgjedhjeve për Kuvendin me qëllim caktimin e një afati kohor të mundshëm për bashkimin e njësisve të qeverisjes vendore para zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në vitin 2006. Prezenca ka ndërvepruar me Kongresin e Këshillit të Evropës për Autoritetet Vendore dhe Rajonale të Evropës, që po jep gjithashtu asistencë për autoritetet shqiptare në lidhje me këtë çështje, për të zhvilluar një nismë të përbashkët.

Reforma Zgjedhore

Në vijim të një marrëveshjeje të arritur më 1 korrik 2004 midis Partisë Socialiste (PS) në pushtet dhe Partisë Demokratike (PD) në opozitë, Prezenca ngriti dhe kryesoi një Grup Ekspertësh Teknikë (GET) me qëllim hartimin e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor në përputhje me rekomandimet e përbashkëta të bëra nga OSBE/ODIHR-i dhe Këshilli i Evropës.² Grupi përfshinte si ekspertë të pavarur ashtu edhe ekspertë të caktuar nga partitë politike dhe përgatiti drafte legislative që duhej t'i paraqiteshin një komisioni të posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore për diskutim dhe marrje vendimi.

Mungesa e një marrëveshjeje në lidhje me përbërjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) bllokoi punën e GET-it dhe të komisionit të posaçëm deri në arritjen e një marrëveshjeje PS-PD më 14 tetor. Marrëveshja, e lehtësuar nga Prezenca, parashikonte që një anëtar i KQZ-së të humbiste vendin e tij dhe që anëtari zëvendësues të caktohej nga partia më e madhe e opozitës, PD-ja. Kjo marrëveshje zgjidhi një prej çështjeve më të debatueshme të zgjedhjeve në të shkuarën në Shqipëri dhe i hapi rrugën miratimit të hapave të tjerë në reformën zgjedhore, si paketa ligjore në lidhje me listat e zgjedhësve dhe fillimi i verifikimit dhe regjistrimit të shtetasve.

Ndryshime të tjera të rëndësishme të hartuara nga GET-i, nën drejtimin e Prezencës, dhe të miratuara nga komisioni i posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore, kishin të bënin me përbërjen e komisioneve zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë, që ishin kritikuar më parë nga ODIHR-i dhe Komisioni i Venecias për mbizotërim të tepruar nga PS-ja dhe PD-ja. Edhe vendimmarrja e këtyre komisioneve u modifikua për të siguruar një mbarëvajtje të funksionimit të tyre, duke hequr votimin me shumicë të cilësuar, që, megjithëse u fut në vitin 2003 për të forcuar besimin, vërtetoi se krijoi bllokime për shkak të politizimit të komisionerëve. Shumica e cilësuar u ruajt vetëm për KQZ-në dhe vetëm për vendime kyçe në lidhje me shpalljen e rezultatit dhe pavlefshmërinë së zgjedhjeve.

Një risi e madhe për procesin zgjedhor shqiptar në vitin 2005 do të jetë numërimi i centralizuar i votave. Në të shkuarën, infrastruktura e dobët, trajnimi i pamjaftueshëm dhe mbipolitizimi i komisionerëve kanë dëmtuar cilësinë dhe efikasitetin e numërimit, që është përcaktuar nga shumë ekspertë shqiptarë si pjesa më problematike e gjithë procesit. Sipas dispozitave të legjislacionit të ri, numërimi i centralizuar do të zhvillohet në 100 qendrat e numërimit nën autoritetin e Komisionit të Zonës Zgjedhore (KZZ). Kjo dispozitë e re do të krijojë hapësirë për një procedurë më transparente nën

² OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës, *Rekomandime të Përbashkëta mbi Kodin Zgjedhor dhe Administratën Zgjedhore në Shqipëri*, Opinion Nr. 273/2004 (Varshavë /Strazburg: 2 nëntor 2004).

vëzhgimin vendas dhe atë ndërkombëtar, një faktor i theksuar veçanërisht nga aktorët shqiptarë. Megjithatë, ka disa shqetësime në lidhje me këtë proces: mungesa e përvojës dhe vështirësi logjistike, së bashku me caktimin me vonesë të numëruesve të lejuar sipas ligjit, përbëjnë pengesa të mundshme për një procedurë numërimi të shpejtë dhe korrekte. Prezenca ka dhënë asistencë konsultative për të siguruar që numërimi i centralizuar i votave të japë vlerën e shtuar të pritshme dhe të ndihmojë për rivendosjen e besimit të publikut shqiptar në saktësinë dhe integritetin e procesit zgjedhor.

Në bazë të këshillës së dhënë nga Prezenca, u futën disa ndryshime të tjera të rëndësishme në lidhje me procedurat për rishikimin administrativ dhe gjyqësor të mosmarrëveshjeve paszgjedhore. Megjithëse ishin bërë ndryshime të rëndësishme në reformën e vitit 2003, zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të të njëjtit vit nxorën në pah nevojën për të përforcuar dhe përmirësuar këto procedura me qëllim shmangien në maksimum të abuzimit me sistemin e apelimeve. Kjo kishte bërë që zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2001 të ishin të tejzgjatura, të pasigurta dhe të fragmentuara, siç u vërejt nga ODIHR-i. Roli i KQZ-së dhe i Kolegjit Zgjedhor, organizmi gjyqësor i ngarkuar me rishikimin e apelimeve zgjedhore, do të jetë kyç në zbatimin e ligjit për suksesin e këtyre rregullimeve. Gjithashtu, janë futur një sërë rregullash të reja për financimin e procesit zgjedhor dhe fushatat e partive politike. Ndërsa dispozitat e mëparshme parashikonin rregullime embrionike, që mund të abuzoheshin lehtësisht, dispozitat e reja prezantuan rregulla më të plota për financimin, shpenzimet dhe bërjen publike të financimeve për fushatën zgjedhore.

Në dhjetor 2004, kur Kodi i reformuar Zgjedhor dukej gati për miratim nga Kuvendi, çështja e kufijve të zonave zgjedhore doli si një çështje kyçe për përmbylljen me sukses të paketës së reformës. Përcaktimi i deriatëhershëm i kufijve të zonave zgjedhore shpesh shkelte kriteret ligjore, dhe kufijtë konsideroheshin gjerësisht si favorizues për shumicën qeverisëse. Për këtë arsye, PD-ja këmbënguli se miratimi i Kodit Zgjedhor nga ana e tyre do të kushtëzohej nga rindarja e zonave zgjedhore.

Nën patronazhin e Prezencës, u ndërmjetësua një tjetër protokoll midis PS-së dhe PD-së më 30 dhjetor, duke ngritur një tjetër grup ekspertësh, të kryesuar nga Prezenca. Megjithëse grupi përfshinte vetëm ekspertë të caktuar nga PS-ja dhe PD-ja, partitë e tjera u ftuan të japin kontributet e tyre. Kjo marrëveshje i hapi rrugë miratimit të Kodit Zgjedhor nga Kuvendi në një seancë të jashtëzakonshme të zhvilluar më 10 janar 2005.

Pas negociatave të gjata, shpesh të ashpra, midis PS-së dhe PD-së u arrit më në fund një marrëveshje kompromisi mbi kufijtë e zonave zgjedhore në fund të shkurtit. Megjithëse harta e re e zonave nuk përmbush plotësisht kriteret ligjore në një numër të kufizuar zonash, ajo prapëseprapë përbën një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me zonat zgjedhore në të shkuarën dhe siguron bazat për një konkurrim më të drejtë. Kuvendi e miratoi ligjin për zonat e reja më 3 mars, duke përmbushur kështu detyrën e fundit të reformës zgjedhore para zgjedhjeve të ardhshme për Kuvendin.

Përveç lehtësimit të procesit politik në themel të reformës së legjislacionit zgjedhor, Prezenca ka dhënë gjithashtu asistencë të mëtejshme teknike për përmirësimin e listave të zgjedhësve dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me rëndësinë e regjistrimit dhe verifikimit të të dhënave të shtetasve. Kjo është mundur nëpërmjet

një projekti me përmasa të mëdha, financuar nga Komisioni Evropian (me vlerë 800 000 euro).

Nëpërmjet këtij projekti, Prezenca ka ndihmuar Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit për ngritjen e 35 qendrave rajonale për hedhjen e të dhënave në gjithë vendin, si një burim shtesë për kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore për të përgatitur listat e zgjedhësve. (Të 72 kompjuterat u dërguan në Shqipëri nga OMiK-u). Më 25 prill, Prezenca i dorëzoi Ministrisë pajisjet për një njësi të centralizuar të përpunimit të të dhënave me qëllim përmirësimin e saktësisë së listave të zgjedhësve, duke siguruar një mjet verifikimi për emra të regjistruar më shumë se një herë, si dhe për gabime të tjera në lista të veçanta të përgatitura nga organet e qeverisjes vendore. Kjo pajisje do të jetë kyçe gjithashtu në një të ardhme afatgjatë, kur Shqipëria të krijojë një regjistër civil të centralizuar dhe plotësisht të kompjuterizuar.

Me ndihmën e mëtejshme të OMiK-ut, Prezenca arriti të mundësonte dhënien në përdorim të 100 kompjuterave, që do t'u shpërndahen çdo KZZ-je. Më tej akoma, organeve zgjedhore shqiptare dhe policisë u është siguruar trajnim në lidhje me zgjedhjet, kryesisht në bashkëpunim me organizma të tjerë ndërkombëtarë (Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian). Nëpërmjet mbështetjes shtesë të donatorëve, Prezenca është e përfshirë në nxitjen e organizatave vendase të shoqërisë civile, si Mjaft! dhe Shoqata e të Verbërve për përfshirje në procesin zgjedhor për të nxitur pjesëmarrjen në votim dhe për të ndihmuar grupe të posaçme zgjedhësish.

Është gjithashtu e rëndësishme të vërehet se marrëveshjet politike të arritura nga PS-ja dhe PD-ja në vitin 2004 parashikonin vazhdimin e reformës zgjedhore në pranverë të vitit 2005. Pas skadimit të afatit për ngritjen e një organi tjetër të posaçëm në Kuvend për këtë qëllim, protagonistët patën mundësi që menjëherë të arrinin një marrëveshje për shtyrjen e mëtejshme të reformës zgjedhore pas zgjedhjeve të vitit 2005. Reforma e ardhshme mund të përfshijë heqjen dorë nga sistemi zgjedhor maxhoritar.

Në mes të muajit maj, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i ODIHR-it, me ftesë të qeverisë shqiptare, u vendos në Shqipëri dhe filloi të monitorojë procesin në përputhje me mandatin.

Deri tani, parakushtet për zgjedhje më të mira janë përmbushur edhe falë mbështetjes së dhënë nga OSBE-ja. Megjithatë, mbeten ende disa probleme që, të ndërthurura, kanë akoma potencialin ta pengojnë Shqipërinë që të zhvillojë zgjedhje që do të përmbushin plotësisht standardet ndërkombëtare. Mbi të gjitha, kontestimi i rezultatit të zgjedhjeve nga humbësit është kurthi më i madh që duhet shmangur. Përgjegjësia është qartazi e partive politike shqiptare dhe udhëheqësve të tyre.

Forcimi i kapaciteteve të Kuvendit

Mbyllja e seancës së fundit të Legjislaturës së 16-të më 20 maj, për t'i hapur rrugë fushatës zgjedhore, përbën rastin e duhur për të njohur zhvillimet e rëndësishme në Kuvendin e Shqipërisë gjatë katër viteve të fundit. Gjatë kësaj kohe, Prezenca ka zbatuar një projekt me fonde jashtë buxhetit të saj për Modernizimin e Kapaciteteve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, financuar nga Holanda. Megjithëse legjislatura u hap me bojkotimin e opozitës pas zgjedhjeve të vitit 2001, Kuvendi, që nga ajo kohë, është bërë gjithmonë e më shumë forumi qendror për shkëmbime dhe debate politike.

Miratimi i Rregullores së Re të Kuvendit në dhjetor 2004, vetëm e ka theksuar këtë përparim të arritur drejt forcimit të kapacitetit institucional të Kuvendit, duke e bërë atë një organ më transparent, më operativ dhe më të përgjegjshëm. Prezenca mbështeti procesin e hartimit të rregullores së re duke siguruar materiale kërkimore dhe burime njerëzore, përfshirë konsulentë nga parlamenti finlandez dhe ai evropian.

Rregullorja e re parashikon përmirësime thelbësore, përsa i përket mbikëqyrjes parlamentare, vendimmarrjes në mënyrë bashkëpunuese, autonomisë buxhetore, zhvillimit organizativ dhe transparencës publike. Rregullorja parashikon ndryshime në strukturën dhe personelin e administratës parlamentare, si dhe forcon rolin e saj në planifikim, hartimin e buxhetit dhe mbikëqyrjen administrative. Transparenca më e madhe ofruar nëpërmjet publikimit të detyrueshëm dhe në kohën e duhur të procesverbaleve të seancave plenare dhe takimeve të komisioneve parlamentare, do t'i ndihmojë grupet e shoqërisë civile dhe median që t'u kërkojnë llogari deputetëve të rinj për veprimet dhe vendimet e tyre.

Kuadri i punës së Prezencës me Kuvendin është përshtatur për të mbështetur reformat e vazhdueshme dhe, për herë të parë, ka pasur një lloj ndryshimi të ritmit të punës së vetë Kuvendit, me përqafimin nga ana e drejtuesve të tij të një përqasjeje më proaktive ndaj zbatimit dhe ndryshimeve.

Anti-trafikimi dhe anti-korrupsioni

Për shumë vjet, lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore ka qenë ndër përparësitë kryesore të programit të qeverisë shqiptare, organizatave ndërkombëtare që punojnë në Shqipëri dhe OJF-ve vendase. Operacione të suksesshme të zbatimit të ligjit kanë ndaluar kalimin e parregullt të kufirit për në Itali me skafë, duke zvogëluar kështu numrin e viktimave të huaja që kalojnë tranzit në Shqipëri. Pavarësisht nga ky përparim, numri i viktimave shqiptare, që shfrytëzohen aktualisht në Evropë, mbetet i lartë, duke treguar se Shqipëria është ende një vend origjine për gratë dhe fëmijët e trafikuar për qëllime të shfrytëzimit seksual dhe punës së detyruar. Megjithëse mbetet një vend tranzit për njerëzit e trafikuar, ndonëse në numra më të vegjël, trafikimi i brendshëm po bëhet një shqetësim në rritje. Si kudo, numri i rasteve të dokumentuara, i cili është rreth disa qindra, besohet të jetë veçse një pjesë e së tërës.

Strategjia Kombëtare e Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2001–2004, hartuar me ndihmën e Prezencës në vitin 2001, është zbatuar pjesërisht nëpërmjet tri planeve kombëtare vjetore të veprimit. Detyra të mbetura pezull, si zbatimi i procedurave të mbrojtjes së dëshmitarëve, si edhe përqasje të reja strategjike janë përfshirë në një Strategji të dytë Kombëtare për periudhën 2005–2007. Shumë shpejt pas vizitës në Shqipëri të Përfaqësuesit të OSBE-së për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, kjo strategji e re, u miratua në muajin shkurt të vitit 2005, së bashku me Strategjinë e parë Kombëtare dhe planin e veprimit, duke u përqendruar te parandalimi i trafikimit të fëmijëve, mbrojtja dhe ri-integrimi i fëmijëve viktimë të trafikimit, ndjekja e trafikantëve të fëmijëve, kthimi vullnetar i asistuar i viktimave dhe bashkërendimi i aktorëve që veprojnë në luftën kundër trafikimit të fëmijëve për periudhën 2004–2006, që kanë qenë në pritje për t'u miratuar për më se një vit.

Qeveria shqiptare është aktualisht duke hartuar një marrëveshje bashkëpunimi për të krijuar një mekanizëm kombëtar referimi për të gjitha viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, që kanë nevojë për ndihmë dhe mbrojtje. Ndihma që i ofrohet aktualisht viktimave të shfrytëzimit seksual nga ofruesit e shërbimeve përkatëse, qeveritare dhe joqeveritare, duhet që përfundimisht të bashkërendohet dhe institucionalizohet. Marrëveshja duhet të përfshijë ndihmë për fëmijët që kanë rënë viktimë, ndihmë që ende nuk ekziston në nivel të mjaftueshëm.

Përmes një projekti dyvjeçar për Përzgjedhjen e Azilkërkuesve dhe Migrantëve, financuar nga projekti CARDS i BE-së, Prezenca, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e saj, UNHCR-në, IOM-in dhe Drejtorinë për Refugjatët pranë Ministrisë së Rendit Publik, po ndërton një sistem identifikimi dhe referimi bazuar në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për viktimat e huaja të trafikimit, azilkërkuesit dhe migrantët e tjerë në Shqipëri. Deri tani, e gjithë policia kufitare shqiptare (234 oficerë të nivelit të mesëm dhe të lartë; 700 roje kufiri) është trajnuar nga Prezenca dhe partnerët e saj në këtë projekt për procedurat e identifikimit dhe referimit. Prezenca ka dërguar gjithashtu gjashtë oficerë vendas përzgjedhës pranë zyrave të saj rajonale, të cilët janë në kontakt të përditshëm me policinë kufitare dhe migrimit për të asistuar rastet e ndryshme dhe për të ndihmuar kalimin e planifikuar të përgjegjësive mbi këtë sistem tek autoritetet shqiptare. Hapat e parë të procesit të këtij kalimi përgjegjësie janë diskutuar gjatë një seminari kombëtar në mesin e muajit maj 2005. Në kuadër të këtij projekti, një ekip prej dhjetë autoritetesh të policisë kufitare po merr pjesë në një tur studimor organizuar në Austri, Slloveni, Kroaci, Itali, Francë dhe Mbretërinë e Bashkuar nga Prezenca për shkëmbim eksperience me homologët e tyre për çështje që kanë lidhje me kufirin dhe migrimin.

Megjithëse deklaratimet e dëshmitarëve përbëjnë një mjet të rëndësishëm në luftën kundër trafikimit, po kuptohet gjithmonë e më shumë se veprimtaria kundër trafikimit përfshin edhe aspekte që përmbajnë elementë të fortë policimi, që i kalojnë dimensionet e të drejtave të njeriut. Krijimi i një kulture operacionesh policore mbështetur më shumë tek informacionet sesa dëshmitë, besohet të rezultojë në përpjekje më të mira kundër trafikimit. Duke pasur këtë gjë parasysh, Prezenca ka ndihmuar, që nga muaji mars 2005, në zhvillimin e konceptit të një njësie të specializuar anti-trafikim, të ekuilibruar nga ana gjinore, brenda Policisë shqiptare të Shtetit, që të jetë përgjegjëse për intervistimin e viktimave të trafikimit, si edhe për hetimin e rasteve të përdhunimit, dhunës në familje dhe krimeve të tjera seksuale. Një aspekt i rëndësishëm i mbledhjes së informacionit përmes kësaj njësie do të sillte një varësi më të vogël në dëshmitë e viktimave në gjykatë. Kjo përjasje bazohet te përvoja ndërkombëtare kundër trafikimit, ku përfshirja aktive e efektivave femra të policisë në nivel operativ ka qenë një stimul i fuqishëm për paraqitjen në polici të viktimave të trafikimit. Projekti, që do të zbatohet me përfshirjen e Njesisë së Çështjeve Strategjike Policore në Vjenë dhe Misionit të Komisionit Evropian të Asistencës për Policinë (PAMECA) është konceptuar si një përpjekje shumëvjeçare.

Zhvillimi i medias

Në fushën e zhvillimit të medias, Prezenca e ka përqendruar punën në dy aspekte bazë, në përputhje me mandatin e saj dhe nevojat e identifikuar të sektorit të medias në Shqipëri: (1) ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve të medias dhe harmonizimin e

legjislacioni të medias me standardet evropiane; (2) rritjen e standardeve etike dhe profesionale të medias shqiptare. Parimi bazë është që t'u ofrojë medias dhe institucioneve të medias ekspertizë të një cilësie të lartë, që media në Shqipëri të jetë më profesionale, më e përgjegjshme dhe më e lirë.

Për arritjen e këtij qëllimi, Prezenca ka punuar ngushtë me Komisionin Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, si dhe me Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), organit shtetëror rregullator të transmetimit. Në përgjigje të kërkesave të bëra më parë nga Kryeministri, KKRT-ja dhe komisioni i medias, Prezenca u siguroi institucioneve përkatëse në tetor 2004 një analizë të hollësishme të legjislacioni shqiptar ekzistues dhe projektligjeve për median.³ Kjo ndihmë u mundësua me anë të mbështetjes së Zyrës së Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias dhe u realizua në bashkëpunim me Këshillin e Evropës. Legjislacioni për median e shkruar dhe transmetimin numerik ishin fokusi kryesor i ligjbërësve dhe publikut gjatë kësaj periudhe. Për të dyja çështjet, Prezencës iu kërkua ndihmë dhe ajo dha një kontribut të konsiderueshëm në hartimin e këtij legjislacioni.

Me kërkesë të komisionit parlamentar të medias, Prezenca ka kontribuar për projektligjin për median e shkruar, që ka qenë një projekt i kahershëm i Kuvendit. Komisioni e pa këtë ligj si një mjet për të trajtuar problemet e shumta që has media e shkruar, të cilat kanë çuar në mungesën e besimit tek ajo, tirazhin e saj të ulët, si edhe në një shkallë të lartë varësie nga politika dhe biznesi. Komisioni e miratoi projektligjin në mars 2005 pas debateve të gjata publike, që u përqendruan vetëm në një nen (neni 10) për përcaktimin e çmimit minimal referues të shitjes për të gjitha gazetat dhe për të përjashtuar në mënyrë përzgjedhëse disa kompani mediash nga pjesëmarrja në tendera publike. Votimi i komisionit erdhi pas një ndërhyrjeje të Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, i cili i shkroi Kryetarit të Kuvendit se metodat e përvijuara në nenin e diskutueshëm nuk ishin të përshtatshme për një ligj për median dhe se debati duhet të përqendrohej në aspekte të tjera të projektligjit “për të pasur një ligj, që do të ishte në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare”. Projektligji nuk u hodh në votë brenda kësaj legjislature të Kuvendit, që u mbyll më 20 maj 2005.

Pas komenteve të përbashkëta të OSBE-së dhe Këshillit të Evropës për ndryshimet e propozuara në ligjin për median elektronike, që kishin lidhje me transmetimin numerik, paraqitur Kuvendit në tetor 2004, komisioni parlamentar i medias ngriti një grup pune në dhjetor 2004 për hartimin e një projektligji për transmetimin numerik eksperimental në Shqipëri. Megjithëse spektri analog në Shqipëri është ende, në një masë të madhe, i parregulluar, nevoja për një ligj të tillë erdhi pasi një operator ka filluar të transmetojë në mënyrë numerike tokësore që në korrik 2004, në kushtet e mungesës së një rregullimi ligjor për këtë lloj transmetimi. Grupi i punës, i përbërë nga përfaqësues të komisionit, KKRT-së, Prezencës dhe Këshillit të Evropës, përgatiti një projektligj në dhjetor 2004, për të mundësuar një kalim të rregulluar në transmetim numerik, duke respektuar parimet e pluralizimit, diversitetit dhe transparencës.

³ Analizat përfshinin komente dhe rekomandime për ligjin për median elektronike, statusin e Radio-Televizionit Shqiptar, legjislacioni për fyerjen dhe shpifjen, ligjin për të drejtën e informimit, projektligjin për median e shkruar, si edhe dy projekte për ndryshime në ligjin për median elektronike për transmetimin numerik.

Në prill 2005, komisioni i Kuvendit për median miratoi një projektligj të ndryshuar thelbësisht, i cili, megjithatë, do të kishte krijuar një monopol *de facto* për operatorin e vetëm ekzistues në treg dhe do të përbënte një shmangie nga natyra kalimtare, eksperimentale e transmetimit numerik në një fazë fillestare. Kjo do të kishte anashkaluar përpjekjet e rregullatorit kombëtar për prodhimin e një strategjie për një zhvillim të planifikuar të transmetimit numerik në Shqipëri. Në maj 2005, Prezenca e informoi Kuvendin lidhur me opinionin e mbështetur bashkërisht nga Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias, Zyra Evropiane e Radiokomunikacioneve, Delegacioni i Komisionit Evropian dhe Zyra e Këshillit të Evropës në Shqipëri për projektligjin. Në seancën e parafundit plenare më 19 maj, Kuvendi me urtësi e kundërshtoi projektligjin e diskutueshëm.

Në ndihmë të komunitetit të medias për të rritur pavarësinë dhe profesionalizmin e tyre, Prezenca ishte në gjendje të zbatonte fazën e parë të projektit të saj për trajnimin e medias lokale për standardet profesionale dhe nxitjen e transparencës në lidhje me ligjin për të drejtën e informimit, falë një donacioni nga organizata qeveritare holandeze *Press Now*. Në disa stacione televizive lokale, si në Kukës, Pogradec, Gjirokastër, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Pukë, Korçë dhe Fier janë zhvilluar trajnime. Qëllimi i projektit është të ndihmojë median jashtë Tiranës të raportojë me më shumë profesionalizëm, të përqendrohet në çështjet lokale dhe të mësojë t'i shohë lajmet me rëndësi kombëtare nga një këndvështrim lokal. Planifikohet që projekti të zgjerohet për të përfshirë gjithë organet e rëndësishme të medias në vend.

Mirëqeverisja dhe zhvillimi i shoqërisë civile

Zhvillimi i shoqërisë civile. Ndikimi në rritje i shoqërisë civile në Shqipëri mbi procesin qeveritar të vendimmarrjes, siç përshkruhet në raporte të mëparshme të Prezencës, po vazhdon, ndërkohë që më shumë OJF dhe grupe të interesuara të publikut po fillojnë gradualisht të ndër marrin veprime për çështje konkrete. Kjo ka qenë veçanërisht e dukshme gjatë debatit për buxhetin vjetor të shtetit në fund të vitit 2004 dhe gjatë periudhës parazgjedhore.

Në këtë kontekst, Prezenca i ka orientuar qendrat e saj të zhvillimit të shoqërisë civile drejt veprimtarive që stimulojnë interesin e shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes lokale, nëpërmjet diskutimeve dhe shpërndarjes së informacionit, duke zhvilluar një proces, ku komunitetet lokale përcaktojnë “vizionin” e tyre. Me qëllim përmirësimit dhe thellimit të bashkëpunimit në nivel lokal janë zhvilluar seanca të plota trajnime, jo vetëm për grupe të shoqërisë civile, por edhe për njësi të qeverisjes vendore. Gjatë gjashtë mujorit të fundit, veprimtaritë e Qendrave të Zhvillimit të Shoqërisë Civile (QZSHHC) janë rritur dhe shërbimet e ofruara prej tyre janë zgjeruar.

Që në fillim të projektit, Prezenca ka kërkuar të sigurojë qëndrueshmërinë afatgjatë të QZSHHC-ve. Një hap i rëndësishëm drejt këtij qëllimi u mor në maj 2005, kur të gjitha QZSHHC-të u regjistruan përfundimisht si OJF në përputhje me legjislacionin shqiptar. Ky status i ri u jep qendrave disa të drejta dhe i bën ato partnere zbatuese dhe të pavarura nga Prezenca. Nga fundi i këtij viti, parashikohet një plan dorëzimi për arritjen e pavarësisë së plotë administrative të qendrave. Një organizatë ombrellë, Rrjeti Kombëtar i QZSHHC-ve, do të marrë përsipër menaxhimin e këtyre qendrave nga

Prezenca, e cila do të monitorojë procesin dhe në mënyrë graduale do të kalojë nga një rol mbikqyrës në një rol këshillues.

Përkatësia gjinore. Përsa i përket çështjes së përkatësisë gjinore, megjithëse në korrik 2004 u miratua një ligj për barazinë gjinore, situata në lidhje me barazinë gjinore është përmirësuar vetëm pjesërisht. Për të trajtuar arsyet kryesore sociale dhe ekonomike për këtë, Prezenca ka punuar ngushtë me Komitetin Shqiptar të Barazisë Gjinore⁴ duke mbështetur përgatitjet e tij për një plan pune për vitin 2005, përfshirë rekomandime për strukturën e tij të ardhshme, dhe raportin kombëtar për procesin e Pekin+10. Gjithashtu, Prezenca përgatiti komente për grupin e punës së Grupit në Mbrojtje të Qytetarëve, i cili u mbledh për të hartuar një ligj për luftën kundër dhunës në familje. Përveç kësaj, Prezenca hapi një Qendër Këshillimore për Gra për viktimat e dhunës në familje në Kukës.

Mirëqeverisja Brenda mandatit të saj, puna e Prezencës është përqendruar gjithashtu në mbështetjen e institucioneve shqiptare të përfshira në luftën kundër korrupsionit. Në këtë kontekst, më shumë se 120 inspektorë nga inspektoriatet financiare u trajnuan nga Inspektoriat i Lartë i Sapongritur i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, me një mbështetje thelbësore programatike dhe teknike nga Prezenca.

Në vijim të veprimtarive të mëparshme të Prezencës në fushën e nxitjes së transparencës dhe mirëqeverisjes, janë organizuar rreth 10 takime me studentë dhe përfaqësues biznesi në bashkëpunim me universitetet lokale të Shqipërisë gjatë periudhës dhjetor 2004 - janar 2005 për të diskutuar rreth etikës së biznesit. Si rezultat konkret i projektit, disa nga universitetet vendosën ta përfshijnë lëndën e etikës në biznes në programet e tyre.

Në mbështetje të punës së saj të mëparshme në fushën e përpjekjeve kundër pastrimit të parave, Prezenca i ka ofruar ndihmë të mëtejshme Bankës së Shqipërisë, konkretisht në zvogëlimin e varësisë nga transaksionet në *cash* dhe identifikimin e veprimeve të dyshimta dhe pret rezultatet e tyre për zhvillimin e programeve vijuese në mbështetje të përpjekjeve kombëtare.

Ndihma për policinë

Duke qenë se aktorë të tjerë të mëdhenj si programi i Departamentit Amerikan të Drejtësisë në ndihmë të policisë (ICITAP) dhe Misioni i Komisionit Evropian në Ndihmë të Policisë në Shqipëri (PAMECA) i ofrojnë mbështetje dhe ekspertizë teknike Ministrisë shqiptare të Rendit Publik, Prezenca është përqendruar te puna me policinë shqiptare të kufirit, e cila ka marrë shumë më pak ndihmë të drejtpërdrejtë ndërkombëtare. Policia shqiptare e kufirit ngre shqetësimin për disa pengesa të mëdha në realizimin e qëllimeve të tyre sipas Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit: mbështetje e varfër logjistike, mungesë e aftësive komunikuese në gjuhë të huaj dhe rotacionet e vazhdueshme të personelit që çojnë në humbje të njohurive institucionale.

Roli i Prezencës, përmendur në raportet e mëparshme, në lehtësimin e bashkëpunimit ndërkufitar me UNMIK/KFOR-in në Kosovë/Serbi dhe Mali i Zi, ka qenë vendimtar në

⁴ Ish-Komiteti Kombëtar për Barazi Gjinore e ndryshoi emrin pas takimit të parë të Këshillit Ndërmintor për Barazi Gjinore, më 4 maj 2005.

ruajtjen e linjave të komunikimit gjatë disa muajve të fundit, krahas disa ndryshimeve organizative dhe ngjarjeve të tjera. Një rezultat konkret i kësaj ka qenë rivendosja e policisë shqiptare të kufirit në pikën e kalimit të kufirit në Qafë Morinë më afër vijës kufitare, duke e rritur kështu kapacitetin e rojeve të kufirit për të vëzhguar gjithë rrugët që çojnë në kufi. Ky bashkëpunim më i afërt ndërkufitar ka kontribuar në zhvillimin e operacioneve të përbashkëta kundër kontrabandës në zonën e Qafë Morinës.

Megjithatë, efektshmëria e policisë kufitare ndikohet nga mungesa e pajisjeve dhe teknologjisë së nevojshme, një situatë që Prezenca është përpjekur ta lehtësojë, ndonëse me burime modeste. Në prill 2005, Prezenca i dhuroi Grupit Operativ Special në qarkun e Kukësit disa automjete 4X4 për plotësimin e nevojave të tyre aftshkurtra për pajisje dhe për të rritur mundësitë e tyre të lëvizjes. Faza e dytë e dhurimit nga ana e Prezencës të sistemit të saj tokësor të komunikimit UHF, i rëndësishëm për përmirësimin e reagimit në kohë të policisë së kufirit në rast situatash emergjente dhe incidentesh, përfundoi në prill. Faza e tretë do të përfundojë në fund të vitit.

Mbështetja materiale nga burimet jashtë buxhetit të Prezencës përfshin sigurimin e paneleve diellore për postat e policisë afër kufirit, të cilat vuajnë nga ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike, në mënyrë që ato të mund të ruajnë një komunikim të vazhdueshëm me autoritetet policore të qarkut dhe qendrës dhe të vazhdojnë të kryejnë detyrat e tyre, si kontrolli i kompjuterizuar i pasaportave. Qëllimi fillestar i projektit të sponsorizuar nga Republika Çeke dhe Franca është siguri i energjisë elektrike të vazhdueshme për sektorët kyç të Drejtorisë së Policisë së Shkodrës dhe postat kufitare kryesore në qarkun e Shkodrës. Parashikohet që kjo iniciativë të shtrihet përgjatë kufirit duke pasur parasysh se gjatë muajit të fundit ka pasur edhe zotime të tjera për mbështetje financiare.

Siç është pranuar edhe nga policia shqiptare e kufirit, qëndrueshmëria e bashkëpunimit më të madh mes kufijve ndikohet gjithashtu edhe nga aftësitë e kufizuara të komunikimit në gjuhë të huaja. Nga fillimi i këtij viti, Prezenca e identifikoi këtë mungesë si një fushë që kërkonte trajnim të përqendruar dhe një kontribut për zhvillim. U përzgjodhën tre posta pilote përgjatë kufirit me Greqinë (Kapshtica, Kakavija dhe Saranda) për t'iu nënshtruar një trajnimi për mësimin e gjuhës së huaj me ndihmën e Këshillit Britanik. Zbatimi i këtij projekti do të fillojë në fillim të vjeshtës.

Hapat në vazhdim

Rrjedhojat e zgjedhjeve të vitit 2005, përsa i përket zhvillimit dhe rezultateve të tyre, do të kërkojnë që Prezenca t'i përshtasë veprimtaritë e saj. Zhvillimi politik i brendshëm i vendit pas zgjedhjeve shpresohet të provojë qëndrueshmërinë dhe efektshmërinë e institucioneve të tij demokratike dhe vendi të vazhdojë t'i ndjekë aspiratat e tij të shumta, në veçanti integrimin e mëtejshëm Euro-Atlantik.

Nga një perspektive rajonale, çështja e statusit final të Kosovës/Serbi dhe Mali i Zi do të jetë e rëndësishme edhe për Shqipërinë, e cila ka luajtur një rol konstruktiv në rajon. Ngjarjet e pritshme rajonale në vitin 2006, që do të lindin nga diskutimet për statusin e Kosovës, duhet të mbahen parasysh, veçanërisht përsa i përket punës së Prezencës në aspektin e sigurisë.

Prezenca do të vazhdojë punën në fushat kryesore programatike, duke i ristrukturuar ato sipas tri dimensioneve të OSBE-së me fokusin te çuarja përpara e reformave shqiptare kryesore duke siguruar ekspertizë dhe, nëse kërkohet, duke lehtësuar proceset politike bazë. Qeverisja e mirë dhe pjesëmarrja e publikut në proceset e vendimmarrjes dhe barazisë gjinore në veprimtaritë e saj kryesore, përfshirë edhe projekte, do të jenë në fokus të veprimtarisë së Prezencës.

Më konkretisht, veprimtaritë nën **dimensionin politiko-ushtarak** të OSBE-së do të përfshijnë *ndihmë* në vazhdimësi *për policinë*, sipas mandatit të Prezencës, në veçanti përmes trajnimit dhe menaxhimit të integruar të kufirit nëpërmjet projekteve më të specializuara.

Me qëllim nxitjen e qeverisjes së mirë, Prezenca do të punojë brenda një programi të ri të ngritur për të mbështetur më mirë përparësitë: *reformën e pronave* në Shqipëri, përfshirë regjistrimin dhe kthimin/kompensimin dhe *reformën administrative territoriale* dhe *qeverisjen e mirë në çështje ekonomike dhe mjedisore*. Puna e Prezencës do t'i rifokusojë burimet për të mbështetur më mirë reformën administrative territoriale që pritet të marrë një impuls të ri pas zgjedhjeve e vitit 2005. Puna fillestare e bërë për zhvillimin e projekteve mbështetëse të pushtetit vendor në vitin 2005 do të rezultojë në një zbatim më të gjerë në vitin 2006. Në mbështetje të strategjive të autoriteteve vendase dhe shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit dhe trafikimit, Prezenca do të fokusohet tek aktorët kryesorë vendas dhe në krijimin e sinergjive ndërdimensionale. Ajo do të vazhdojë gjithashtu të nxisë etikën në biznes dhe zhvillimin e biznesit të vogël. Gjithashtu, parashikohet edhe rritja e ndërgjegjësimit për mjedisin dhe mbështetja për aktorët mjedisorë vendas dhe rajonalë.

Përsa i përket **dimensionit human**, puna do të vazhdojë duke mbështetur më tej *reformën zgjedhore dhe parlamentare*. Duke pasur parasysh zgjedhjet për qeverisjen vendore nga fundi i vitit 2006, mund të nevojitet mbështetje e mëtejshme për reformën zgjedhore, nëse kërkohet, pasi marrëveshjet politike të arritura në vitin 2005 kanë identifikuar tashmë rëndësinë e rishikimit të gjithë sistemit zgjedhor shqiptar (me rrjedhoja të mundshme kushtetuese).

Në fushën e *shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut*, projektet e reformës gjyqësore synojnë të luftojnë korrupsionin dhe të rrisin besimin e publikut te sistemi gjyqësor dhe përmirësimin e standardeve të të drejtave të njeriut, sidomos në fushat e gjykimit të drejtë, drejtësisë për të mitur, arsimit për pakicat, dhe të drejtave të punëtorëve. Prezenca do të vazhdojë të zhvillojë e të rishikojë legjislacionin përkatës dhe të sigurojë asistencë për mbështetjen e ndryshimeve sistemike dhe strukturore në një sërë institucionesh, përfshirë gjykatat, prokuroritë dhe Zyrën e Avokatit të Popullit.

Prezenca, duke qenë aktive në sigurimin e asistencës për legjislacionin në lidhje me lirinë e medias, do të vazhdojë të asistojë në rritjen e profesionalizmit të sektorit të medias dhe në promovimin e etikës në media. Mbështetja për *shoqërinë civile*, konkretisht nëpërmjet rrjetit të Qendrave të Zhvillimit të Shoqërisë Civile do të vazhdojë, me një theks më të madh te pronësia shqiptare përsa i përket përfundimit të procesit të filluar në vitin 2005 për t'i bërë qendrat të vetëqëndrueshme.

Brenda kuadrit të koordinimit të donatorëve, Prezenca do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë me organizata të tjera ndërkombëtare dhe donatorë aktivë në Shqipëri dhe të vlerësojë në mënyrë proaktive programet e të tjerëve për të siguruar se ata plotësojnë njëri-tjetrin dhe për të shmangur mbivendosjet. Prezenca do të vazhdojë gjithashtu të luajë një rol kyç si një nga katër anëtarët e sekretariatit të Strukturës së Ko-ordinimit të Donatorëve (së bashku me Komisionin Evropian, Bankën Botërore dhe PNUD-in). Në këtë kontekst, Prezenca do të mbështesë funksionimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar të Qeverisë duke pasur si pikësynim arritjen e përvetësimit të procesit të bashkërendimit nga pala shqiptare.

Projekti i Prezencës do të orientohet nga mandati dhe kërkesa dhe do të mbështetet te konsultimet e plota me autoritetet përkatëse shqiptare, si dhe në transparencë. Pas Programit të paraqitur të Prezencës për vitin 2006 qëndron presupozimi i një rritjeje reale të nivelit zero; raporti i përgjithshëm midis kostove programatike dhe atyre operative në buxhet do të ruhet. Prezenca planifikon të ruajë kapacitetin aktual të personelit dhe të ripërshtasë strukturën e saj të zyrave rajonale për të mbështetur gjithnjë e më shumë zbatimin e projekteve të saj në shkallë vendi.